

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M
Nr. 37 datë 13.12.2025

**NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 107 DATË 18.12.2024 " PËR
MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË PËRMET VITI 2025"**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", i ndryshuar, Ligjit nr.43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë" VKM nr.775 datë 24.09.2010 "Per administrimin e financimeve të huaja", Udhëzimi nr.10 datë 12.07.2024 "Për rregjistrimin ,përdorimin,rakordimin,raportimin dhe publikimin e fondeve te financimeve të huaja në kuadrin e marreveshjes nderkombëtare", Ligji 115/2024,"Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimit nr. 2 datë 24.01.2025 " për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", Email për transferim fondesh nga Lead Partner për projektin ARCHETHICS datë 11.11.2025, VKB nr.91 datë 22.10.2025" Për miratimin e planit Vendor për Emergjencat Civile", Shkresa nr.14505/30 datë 27.10.2025 "Për zbatimin e Aktit Normativ nr.10 datë 08.10.2025", Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1.1 Të shtohet zëri i të ardhurave si më poshtë:

Rimbursim shpenzimesh pas vlerësimit të performancës të projekteve të huaja në vlerën 1,219,314 lekë

1.2 Të shtohen shpenzimet në strukturën e mëposhtme:

Në lekë

Strukturat	Programi	Kod Produkti	Kap	600 (paga)	602 (shpenzime operative)	Pershkrim
Perfshirja sociale	AC135	V043AAA	05	802134	417000	Projekti RIWET

2.1 Të pakësohen të ardhurat me kap 02(financime nga projekte të huaja për projektin RIWET) në vlerën 3 505 000 lekë.

2.2 Të pakësohen shpenzimet me kap 02 (për projektin e huaj RIWET) në vlerën 3 505 000 lekë sipas detajimeve të mëposhtme:

Në lekë

Strukturat	Programi	Kod Produkti	Kap	600 (paga)	601(siguri me)	602 (shpenzime operative)	Pershkrim
Perfshirja sociale	AC135	P043AAP	02	1755000	130000	1620000	Projekti RIWET

3.1 Të pakësohen shpenzimet në strukturën buxhetore:

Në lekë

Strukturat	Programi	Kod Produkti	Kap	609(Fondi rezerve dhe nacional per kontigjencat)	Pershkrim
Siguria qytetare dhe mbrojtja e mjedisit	AE135	V328AAC	01	1 300 000	Fond emergjence

3.2Të shtohen shpenzimet në strukturën buxhetore:

Në lekë

Strukturat	Programi	Kod Produkti	Kap	231 (investim)	Pershkrim
Siguria qytetare dhe mbrojtja e mjedisit	AE135	V328AAC	01	1 300 000	Blerje dhe vendosje sistem sigurie kamerash

4.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet –Financës dhe Drejtoritë e Projekteve të Huaja dhe Drejtoritw e tjera.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

(Signature)

KRYETAR
Anila DHIMITRI

